

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Ap – Kž – 353/2009
14 qershor 2011
Prishtinë

N Ë E M Ë R T Ë P O P U L L I T


Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Charles Smith si Kryetar i kolegjit me gjyqtarët e EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger dhe Martti Harsia si dhe gjyqtaret e Gjykatës Supreme Marije Ademi dhe Emine Mustafa si anëtarë të kolegjit, të ndihmuar nga Zyrtarja Ligjore e EULEX-it Olivia Debaveye si procesmbajtëse,

Në lëndën penale kundër të pandehurit **Gjelosh Krasniqi**, shqiptar kosovar. i lindur më _____, in fshatin _____ komuna e _____, emri i babait _____ emri i nënës _____, me banim në fshatin _____, komuna e _____, me numer personal identifikues të Dokumentit të udhëtimit për _____ në paraburgim nga data 27 maj 2008 deri më 24 shtator 2008 si dhe nga / nëntor 2008 gjer më tani, aktualisht i burgosur në burgun e Dubravës,

I dënuar nga Gjykata e Qarkut të Pejës më 29 prill 2009 për veprën penale të **Krimeve të luftës kundër popullsisë civile**, në kundërshtim me Nenin 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste të Jugosllavisë, Nenet 3 dhe 147 të Konventës së katërt të Gjenevës si dhe Nenit 4 të Protokollit II shtesë të Konventës së Gjenevës, për marrjen peng të P _____ L _____ dhe për konfiskimin e kundërligjshëm të pasurisë dhe për grabitjen e një pushke AK – 47 si dhe të një revole të kalibrit 7.65 mm nga P _____ L _____ pastaj të një pushke M – 48 nga T _____ K _____, të një pushke M – 48 dhe të një revole CZ 99.9 mm nga G _____ Q _____ dhe të një revole 7.65 mm bronvik nga M _____ P _____, në fshatin Doblbare, komuna e Gjakovës, më datën 24 mars 1999,

Duke vepruar sipas ankesës së të pandehurit, të paraqitur përmes Avokatit të vet mbrojtës Haxhi Millaku më datë 19 gusht 2009 kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Pejës në lëndën P. Nr. 67/09, të datës 29 prill 2009, përmes të cilit gjykata e ka shpallur fajtor të pandehurin dhe e ka dënuar të njëjtin me shtatë (7) vjet burgim.

Pas mbajtjes së seancës më 14 qershor 2011, e cila ka qenë e hapur për publikun dhe në praninë e Prokurorit të Shtetit të përfaqësuar nga Prokurorja e EULEX-it Gabrielle Walentich, të avokatit mbrojtës Haxhi Millaku si dhe të vetë të pandehurit, pas këshillimit dhe votimit të mbajtur të njëjtën ditë më 14 qershor 2011,



Më 14 qershor 2011, në përputhje me Nenin 392 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), publikisht dhe në prani të Avokatit mbrojtës Haxhi Millaku dhe prokurorit të EULEX-it të PSRK-së, shpall këtë

AKTGJYKIM

Ankesa e ushtruar në emër të të pandehurit Gjelosh Krasniqi kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Pejës në lëndën P. Nr. 67/09, të datës 29 prill 2009, me këtë aktgjykim REFUZOHET si e pabazë.

Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Pejës vërtetohet.

ARSYETIMI

I HISTORIA E PROCEDURËS

Aktvendimi mbi fillimin e hetimeve është paraqitur nga prokurori ndërkombëtar më 13 mars 2008 kundër të pandehurit. Pas lëshimit të urdhër arrestit më 19 maj 2008, i pandehuri u arrestua më 27 maj 2008 dhe rrjedhimisht u paraburgos.

Më 4 dhjetor 2008, PSRK-ja paraqiti aktakuzën PP.nr 88/208 në Gjykatën e Qarkut në Pejë kundër Gjelosh Krasniqit për vepër penale të **Krimeve të luftës kundër popullsisë civile**, në kundërshtim me Nenin 142 të Kodit Penal të SFRJ-së, Nenet 3 dhe 147 të Konventës së katërt të Gjenevës si dhe Nenet 4 të Protokollit II shtesë të Konventës së Gjenevës.

Aktakuza u confirmua me aktvendimin e lëshuar më 20 janar 2009 pas shqyrtimit të mbajtur më 19 janar 2009 në Gjykatën e Qarkut në Pejë.

Shqyrtimi gjyqësor u mbajt në Gjykatën e Qarkut në Pejë më 11, 12, 17, 18, 19, 31 mars, 23, 24, 27 dhe 29 prill 2009 në prani të të pandehurit Gjelosh Krasniqi, avokatit të tij mbrojtës Haxhi Millaku dhe Prokurorit Special Robert Dean. Trupi gjykues i përbërë prej dy Gjyqtarëve të EULEX-it dhe një Gjyqtari vendor dëgjoi dëshmitë e 18 dëshmitarëve dhe 27 dokumente u lexuan si prova. Me aktgjykimin e shpallur më 29 prill 2009, Gjykata e Qarkut në Pejë shpalli të pandehurin Gjelosh Krasniqi fajtor për krime të luftës kundër popullsisë civile për marrjen peng të P L dhe për konfiskimin e kundërligjshëm të pasurisë dhe për grabitjen e një pushke AK – 47 si dhe të një revole të kalibrit 7.65 mm nga Pashk Luli, pastaj të një pushke M – 48 nga T K , të një pushke M – 48 dhe të një revole CZ 99.9 mm nga G Q dhe të një revole 7.65 mm bronvik nga M P . Ai u dënua me shtatë vjet burgim.

Aktgjykimi iu dorëzua të pandehurit Gjelosh Krasniqi më 3 gusht 2009.



Më 18 gusht 2009 avokati mbrojtës Haxhi Millaku paraqiti ankesë në emër të të pandehurit kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë.

Më 4 shtator 2009 Prokurori i PSRK-së paraqiti përgjigjen e tij ndaj ankesës së të pandehurit dhe Gjykata Supreme e pranoi mendimin dhe propozimin e Prokurorisë së Shtetit të Republikës së Kosovës (ZPSHK) të përfaqësuar nga Prokurori i EULEX-it më 21 prill 2011.

II ANKESA E MBROJTJES DHE PËRGJIGJA E PROKURORISË

II.1. Ankesa e avokatit mbrojtës

Avokati mbrojtës Haxhi Millaku kundërshton aktgjykimin e shkallës së parë mbi këto arsye: shkeljes esenciale të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendim të gabuar lidhur me sanksionin penal. Ai kërkon të anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut dhe lënda të kthehet për rigjykim dhe një vendim të ri ose të ndryshohet aktgjykimi me qëllim që i pandehuri të lirohet apo të shqiptohet një dënim më i butë ndaj tij.

Pikat kryesore të ankesës mund të përmbliidhen kështu:

II.1.1. Identifikimi i të pandehurit nga ana e dëshmitarëve


Një numër i dëshmitarëve (G. L., P. L., B. L., E. L.) dëshmuan se P. L. ishte marrë nga një person që e kishte prezantuar veten si Gjelosh Krasniqi i cili nuk është i pandehuri i pranishëm në gjykatore. Ekziston një mangësi në identifikimin dhe njohjen e të pandehurit, prandaj Gjelosh Krasniqi nuk duhet të dënohet për veprimet e një individi tjetër që shtret se është Gjelosh Krasniqi.

Hetuesi i policisë Hazbi Agjami dëshmoi se G. L. e kishte thirrur atë disa herë për të siguruar informata rreth vendndodhjes së Gjelosh Krasniqit por avokati mbrojtës pohon se C. L. asnjëherë nuk e kishte parë vetë të pandehurin drejtpërdrejt dhe kurrë nuk e kishte takuar atë.

Besueshmëria e dëshmisë së C. L. gjatë hetimeve kundërshtohet pasi ai tha se kishte dëgjuar të pandehuri të thotë në natën kritike: “Nëse Gega dhe Mema japin leje, ata do ta lirojnë atë” kurse dëshmitari Gega Lleshi dëshmoi se vëllai i tij Mema ishte vrarë më 28 janar 1999 (para natës kritike).

II.1.2. Konfiskimi i kundërligjshëm i pasurisë nuk ishte vlerësuar drejt.

Avokati mbrojtës pohon se armët nuk ishin marrë nga ata në mënyrën që do të përbente plaçkitje apo konfiskim të kundërligjshëm, por se dëshmitarët ua dorëzuan armët ushtarëve kur u kërkua nga ata “vullnetarisht, pa asnjë frikësim apo kërcënim”.



II.1.3. Papranueshmëria e dëshmimeve të dëshmitarëve B L dhe E L

Gjatë fazës hetimore, policia intervistoi B L dhe E L bashkë në dhomë të njëjtë dhe në shtëpinë e familjes së tyre, prandaj dëshmitë e tyre janë të papranueshme dhe trupi gjykues nuk është dashur t'i marrë parasysh.

II.1.4. Alibia e paraqitur nga dy dëshmitarët e mbrojtjes nuk është vlerësuar drejt

Trupi gjykues nuk ka vlerësuar drejt alibinë e të pandehurit të paraqitur nga dy dëshmitarët Kole Krasniqi dhe Pashk Krasniqi të cilët dëshmuuan se i pandehuri ishte me ta gjatë tërë kohës në natën kritike duke festuar fillimin e sulmeve ajrore të NATO-s në fshatin Nepole dhe prandaj ai nuk ka mundur të jetë në të njëjtën kohë në fshatin Doblbare.

Mbrojtja pohoi se i pandehuri ishte kuzhinier në UÇK e jo ushtar dhe se ai nuk kishte armë.

II.1.5 Sanksioni penal

Në fund, avokati mbrojtës pohon se, sa i përket dënimit, trupi gjykues i morri parasysh vetëm rrethanat rënduese (siç janë dënimet e mëparshme) por jo edhe rrethanat lehtësuese (anëtarët r sëmure të familjes dhe gjendjen e varfër ekonomike).


II.2. Përgjigja e PSRK-së

Prokurori i PSRK-së me përgjigjen e tij të datës 4 shtator 2009 pohon se ankesa është e pabazuar dhe se duhet të refuzohet dhe kërkon nga Gjykata Supreme ta vërtetojë aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë të datës 29 prill 2009.

Në veçanti, sa i përket arsyeve të ngritura nga mbrojtja, Prokurori i PSRK-së përgjigjet kësisoj:

II.2.1. Lidhur me mungesën e identifikimit të të pandehurit

Gjatë fazës hetimore, një numër i dëshmitarëve vazhdimisht pohuan se P L ishte marrë në natën kritike nga Gjelosh Krasniqi. Disa prej tyre shtuan se ai është nga fshati Nepole, disa pohuan se e njihnin atë dhe se ishin madje shokë me të. Ata të gjithë ndryshuan versionet e tyre gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe pohuan se në fakt personi i prezantuar si Gjelosh Krasniqi e mori P L me vete atë natë. Kjo asnjëherë nuk ishte përmendur gjatë fazës së hetimeve. Ndryshimi i versionit nga i biri i P L, G L, ndodhi menjëherë pas lirimit të të pandehurit nga paraburgimi në shtator 2008. Prokuroria po ashtu potencoi se mbrojtja e pranon se një takim kishte ndodhur në mes familjeve të Gjelosh Krasniqit dhe G L me ndërmjetësimin e Pal Krasniqit. Pas atij takimi i cili kishte ndodhur në vitin 2008, qëndrimi i dëshmitarit G L drejt organeve të hetuesisë ndryshoi dukshëm.



Prokuroria më tutje pohon se G L e dinte shumë mirë kush ishte i pandehuri pasi që ai tregoi në polici se ishte nga fshati Nepole dhe se e kishte takuar atë disa herë pas luftës dhe dha përshkrimin fizik të të pandehurit. Ai i tregoi policit hetues se e kishte parë atë drejtpërdrejt sikur se që e kishin parë edhe njerëzit e tjerë.

II.2.2. Vlerësimi i gabuar i alibisë së të pandehurit

Prokuroria theksoi se dëshmitë e dy dëshmitarëve të mbrojtjes të cilët ofruan alibi për të pandehurin për natën kritike përmbajnë një numër kundërthëniesh. Në veçanti lidhur me moshën e ushtarëve të UÇK-së të pranishëm atë natë, praninë e të pandehurit mëngjesin e nesërm apo atmosferën në fshat në atë natë. Prokurori po ashtu nënvizoi “gjasat e vogla” që ushtarët e UÇK-së të festonin tërë natën dhe të deheshin marrë parasysh gjendjen shumë të tensionuar dhe aktivitetin e shtuar ushtarak në zonën përreth në atë natë. Prokurori po ashtu hedh poshtë se i pandehuri ishte kuzhinier në UÇK, që është vërtetuar me një numër dokumentesh të UÇK-së, të cilat ishin pranuar si prova.

II.2.3 Lidhur me cilësimin e marrjes me forcë të armëve të zjarrit si konfiskim të kundërligjshëm të pronës dhe plaçkitje

Prokuroria theksoi se mbrojtja nuk kundërshton faktet se P L , T K , G Q dhe M P i dorëzuan armët e tyre. Prokuroria pretendon se i pandehuri dhe ushtarët e tjerë të UÇK-së ishin duke kaluar nëpër fshat me Pashk Lulin si peng që si pasojë i detyroi fshatarët e tjerë t'i dorëzonin armët e tyre. Ata ishin të frikësuar dhe nuk i dhanë këto armë me vullnetin tyre të lirë dhe pa kërcënime. Në fund të fundit ata ishin civilë.

II.2.4. Lidhur me dëshmitë në polici të B dhe E

Prokuroria pretendon se fakti që B dhe E L ishin dëgjuar së bashku nga polici Hazbi Agjami ishte vetvetiu një parregullsi por jo një shkelje esenciale e procedurës penale dhe nuk mund të konsiderohet *në vete* si provë e papranueshme.

II.3. Mendimi i Prokurorit të Shtetit i datës 21 prill 2010

Prokurori i Shtetit në mendimin dhe propozimin e tij faktin se nuk ekzistojnë arsye për të kundërshtuar aktgjykimin e ankimuar dhe pajtohet me përgjigjen e Prokurorit të PSRK-së për ta refuzuar ankesën e të pandehurit si të pabazuar.

III GJETJET E GJYKATËS

III.1. Pranueshmëria e ankesës

Gjykata Supreme gjen se ankesa në emër të të pandehurit është e paraqitur me kohë dhe është e pranueshme. Aktgjykimi i ankimuar i është dorëzuar të pandehurit më 3 gusht 2009 dhe mbrojtja paraqiti ankesën në Gjykatën e Qarkut në Pejë më 18 gusht 2009.



brenda afatit kohor prej pesëmbëdhjetë ditësh siç përcaktohet me nenin 398 të KPPK-së. Ankesa është paraqitur nga avokati mbrojtës si person i autorizuar.

Gjykata Supreme gjen se ankesa nuk është e bazuar. Kolegji, tani do ta vlerësojë secilin argument të ngritur në ankesën e avokatit mbrojtës.

III.2. Identifikimi dhe njohja e të pandehurit

Gjykata Supreme nuk konsideron se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar në mënyrë të gabuar gjendjen faktike në lidhje me çështjen e identifikimit të të pandehurit.

Pas shqyrtimit me kujdes të shkresave të lëndës, dhe në veçanti të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor në të cilin 18 dëshmitarë kanë dhënë dëshmitë e tyre dhe deklaratave të dhëna nga një numër i dëshmitarëve gjatë fazës së hetimeve, kolegji ka identifikuar se ekziston një mospërputhje e qartë në mes të versionit të përgatitur gjatë fazës hetimore, p.sh. Gjeloš Krasniqi, një person të cilin dëshmitarët e kanë njohur ka marrë P L dhe versionit të paraqitur nga dëshmitarët në gjykatë, p.sh. personi i cili e ka prezantuar veten si Gjeloš Krasniqi e ka marrë P L në natën kritike.

Përderisa roli i gjykatës së shkallës së parë është që të vlerësojë dhe sqaroj në aktgjykim i cili e konsideron këtë fakt si të provuar ose jo dhe mbi çfarë baze, dhe të vlerësojë besueshmërinë e provave kundërthënëse, Gjykata Supreme do të shqyrtojë dhe marrë parasysh nëse ky vlerësim dhe peshimi i procesit të provave është bërë në mënyrë të hollësishme dhe të rregullt për ta vërtetuar gjendjen faktike.

Shembulli më goditës i mospërputhjes në mes të versioneve të procedurës paraprake dhe shqyrtimit gjyqësor është dhënë nga pala e dëmtuar, G I , i cili është djali i viktimës. Pala e dëmtuar ka dhënë gjithsej gjashtë dëshmi: dy për hetuesit e TPN-së për ish Jugosllavinë të datës 18 janar 2003 dhe 2 mars 2004, dhe katër për Policinë e UNMIK-ut të datës 6 janar 2008, 1 mars 2008, 26 gusht 2008 dhe 7 tetor 2008. Në gjykatë ai ka dëshmuar se babai i tij është marrë nga një grup i individëve në uniform, njëri prej të cilëve është prezantuar si Gjeloš Krasniqi. Ai vazhdimisht ka deklaruar gjatë dëshmisë së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor se personi i cili e ka marrë babanë e tij në natën kritike nuk është personi i njëjtë si i pandehuri në këtë lëndë. Në asnjërën prej gjashtë dëshmive të tij të mëparshme ai nuk e ka përmendur këtë fakt.

Gjykata e shkallës së parë në mënyrë intensive e ka sfiduar palën e dëmtuar gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 11 mars 2009, dhe në veçanti lidhur me faktet në vijim:

- se pala e dëmtuar tanimë e kishte njohur të pandehurin kur P I është marrë dhe se ai ishte takuar me të pas luftës;
- se pala e dëmtuar ka hedhur poshtë akuzat më 7 tetor 2008 kundër Gjeloš Krasniqit pasi që babi i tij kishte veshur uniformën e gabuar;
- si i pandehuri kishte vozitur një Mercedes 320;
- se ai papritur kishte hasur në të pandehurin në Gjakovë pas luftës.



Gjykata Supreme, gjithashtu i ka kushtuar rëndësi të konsiderueshme arsyeve kundërthënëse të paraqitura nga G. L. sa i përket tërheqjes së akuzave kundër Gjelosh Krasniqit në tetor 2008 dhe në mars 2009. Në të vërtetë, në tetor të vitit 2008, G. L. ka dhënë indikacione se dëshiron t'i tërheq akuzat kundër të pandehurit pasi që babai i tij kishte veshur uniformën e gabuar. Sidoqoftë, në mars 2009, ai ka theksuar se arsyeja kryesore pse nuk dëshiron më tutje ta inkriminoj Gjelosh Krasniqin është për shkak se ai ishte liruar nga paraburgimi nga një gjyqtar (i pandehuri është liruar nga paraburgimi në mes të 24 shtatorit 2008 dhe 7 nëntorit 2008). Kjo mospërputhje ka vënë dyshime të mëdha në kredibilitetin e këtij dëshmitari, pasi që sqarimi i tij konsiderohet të jetë tërësisht jologjik.


Gjykata Supreme konsideron se kryetari i kolegjit në shumë raste ia ka tërhequr vëmendjen dëshmitarit lidhur me dëshmitë e tij të mëparshme dhe ka kërkuar arsyet pse ai po dëshmon ndryshe, në pajtim me nenin 364 të KPPK-së. Arsyet e dhëna nga pala e dëmtuar G. L. për ndryshimet në mes të dy versioneve janë se dëshmitë me shkrim nuk përputhen me informatat e dhëna nga dëshmitari gjatë intervistave. Gjykata Supreme vëren se shumica e këtyre dëshmive janë hartuar në gjuhën shqipe dhe janë nënshkruar nga pala e dëmtuar.

Mospërputhje të ngjashme janë vërejtur në mes të dëshmive të dëshmitarëve në vijim:

- B. L. i cili i është referuar një personi i cili e kishte prezantuar vetën si Gjelosh Krasniqi në dëshminë e tij të dhënë në gjykatë më 12 mars 2009 dhe “Gjelosh Krasniqit nga fshati Nepole” në dëshminë e tij të dhënë më 16 mars 2008,
- E. L. i cili i është referuar një personi i cili e kishte prezantuar vetën si Gjelosh Krasniqi në dëshminë e tij të dhënë në gjykatë më 17 mars 2009 dhe “Gjelosh Krasniqit nga fshati Nepole” të cilin ai gjithashtu e kishte takuar pas luftës në një pompë të karburanteve në fshatin Doblisar.
- P. L. i cili i është referuar ushtarëve të UÇK-së të cilët nuk i kishte njohur, në dëshminë e tij të dhënë në gjykatë më 17 mars 2009 dhe Gjelosh Krasniqit dhe tre individëve të tjerë në dëshminë e tij të dhënë më 16 janar 2008.
- M. P. i cili i është referuar individëve në uniform prej të cilëve asnjërin nuk e kishte njohur në dëshminë e tij të dhënë më 18 mars 2009 dhe Gjelosh Krasniqit të cilin e njohte pasi që ishin shokë në dëshminë e tij të dhënë më 11 prill 2008.
- C. Q. i cili i është referuar ushtarëve me simbole shqiptare në dëshminë e tij të dhënë në gjykatë më 18 mars 2009, dhe Gjelosh Krasniqit në dëshminë e tij të dhënë më 11 prill 2008.

Gjykata Supreme është e kënaqur se të gjithë këta dëshmitarë janë konfrontuar gjerësisht gjatë shqyrtimit gjyqësor nga trupi gjyqësor, e cila është raportuar në aktgjykim prej faqes 21 deri në 51. Arsyet e dhëna për mospërputhje kanë qenë çështjet e përkthimit ose dëshmitë e dhëna gjatë fazës hetimore nuk janë përpiluar në pajtim me atë që është thënë gjatë intervistave. Sidoqoftë, Gjykata Supreme ka vërejtur se deklaratat kanë qenë të shkruara me dorë në gjuhën shqipe dhe të nënshkruara nga dëshmitarët.

Siç është deklaruar në aktgjykimin e *Vladimir Ukaj, Robert Sylaj dhe Sabri Istaiti* (Ap Kz 428/2007 të datës 28 maj 2007),



“Gjykata Supreme e Kosovës duhet pajtetër të pajtohet me vlerësimin e trupit gjykues lidhur me kredibilitetin e dëshmitarëve të cilët janë paraqitur personalisht para tyre ose të cilët kanë dëshmuar personalisht para tyre. Nuk është e përshtatshme për Gjykatën Supreme të Kosovës që ta refuzoj vlerësimin lidhur me kredibilitetin e atyre dëshmitarëve, përveç nëse ekziston një bazë e shëndoshë për një gjë të tillë”.

Rrjedhimisht, Gjykata Supreme e Kosovës në këtë lëndë të veçantë është e bindur se kredibiliteti i dëshmitarëve të lartpërmendur është sfiduar në mënyrë të mjaftueshme nga trupi gjykues deri në arritjen e përfundimit se versioni i dhënë gjatë fazës hetimore ka qenë versioni më i besueshëm.

Dispozitat e procedurës penale përcaktojnë se gjykata paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara, si dhe arsyet për këtë. Gjykata gjithashtu në mënyrë të veçantë vlerëson saktësinë e provave kundërthënëse. Gjykata Supreme gjen se vlerësimi i provave është bërë nga gjykata e shkallës së parë në pajtim me kushtet ligjore dhe në mënyrë të kujdesshme, transparente dhe bindëse. Në përfundim, Gjykata Supreme nuk gjen vërtetim të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike në aktgjykimin e ankimuar.

III.3. Plaçkitja dhe konfiskimi i kundërligjshëm i pronës dhe armëve të civilëve

Avokati mbrojtës, duke mos e kundërshtuar faktin se një numër i armëve i është dorëzuar ushtarëve në natën kritike nga palët e dëmtuara P L , T K , G Q dhe M P , cilësimi si plaçkitje dhe konfiskim i kundërligjshëm i pronës nuk është cilësim juridik i drejtë për këtë veprim pasi që asnjë element i forcës apo kërcënimit nuk është përdorur për marrjen e armëve nga civilët. Prandaj, avokati mbrojtës pretendon në shkelje të ligjit penal.

Gjykata Supreme ka shqyrtuar nëse marrja me forcë e armëve nga civilët është veprë penale e cila përbën Krime të luftës kundër popullatës civile sipas KP të RSFJ-së dhe sipas instrumenteve ndërkombëtare, dhe nëse është zbatuar ndonjë ligj i pa-aplikueshëm.

Së pari, ligji penal në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë KP i RSFJ-së dhe neni i tij 142 i referohet një liste të akteve që cilësohen si Krime të luftës kundër popullatës civile, si “konfiskimi i pronës” dhe “plaçkitja”.

Së dyti, duke i analizuar Konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe Protokollet shtesë të Konventave të Gjenevës të vitit 1977 (si dhe ligjit të aplikueshëm pasi që Jugosllavia ka qenë palë e Konventave të Gjenevës dhe Protokolleve shtesë), Gjykata Supreme vëren se sipas **nenit 4 paragrafit 2 pikës g** të Protokollit shtesë II (mbi mbrojtjen e personave civil) të Konventave të Gjenevës i referohet ndalimit të përgjithshëm të plaçkitjes së civilëve dhe nenit 33 të Konventës së 4-të të Gjenevës i cili përcakton se plaçkitja është e ndaluar.



Komentari lidhur me këtë nen sqaron se ndalimi është absolut dhe i garanton të gjitha llojet e pronave. Përrjashtim i vetëm është marrja e ushqimit, furnizimit mjekësor ose spitalet civile (nenet 55 dhe 57 e Konventës së Gjenevës) ose të pajisjeve ushtarake të palës së kundërt, pasi që në përgjithësi është e pranueshme në konfliktet e armatosura ndërkombëtare.

Sipas jurisprudencës së TPN, “grabitja” dhe “plaçkitja” janë terme të ngjashme që përdoren për të përshkruar “përvetësimin e kundërligjshëm të pronës private dhe publike gjatë konfliktit të armatosur”, siç është theksuar në aktgjykimin Celibici të datës 16 nëntor 1998.

Plaçkitja është shkelje e së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare NËSE prona ka vlerë të rëndësishme dhe NËSE plaçkitja ka pasoja të rëndësishme për viktimat. Për më tepër, vepra penale grabitje ose plaçkitje ekziston kur kryhet në mënyrë të kundërligjshme dhe me qëllim (aktgjykimi *Hadzihasanovic dhe Kubura*, 15 mars 2006).

Në këtë lëndë, janë marrë armët nga civilët (P. L., T. K., G. Q. dhe M. P.). Ushtarët ishin duke ecur nëpër fshat me Pashk Lulin të mbajtur si peng kur i kanë kërkuar armët nga fshatarët. Njëri prej dëshmitarëve i është referuar faktit se ai i kishte dorëzuar armët e tij edhe pse kishte leje për to pasi që ishte frikësuar se do të ishte në telashe në rast se nuk do të vepronte në atë mënyrë.

Prandaj, Gjykata Supreme konsideron se marrja e armëve është kryer në mënyrë të kundërligjshme dhe të qëllimshme, si përjashtim i cilësimit të plaçkitjes, p.sh. për ushqim, furnizime mjekësore dhe/ose spitale civile nuk është i aplikueshëm në këtë lëndë dhe se ushtarët në mënyrë eksplicite i kanë kërkuar armët nga civilët. Përveç kësaj, vlera e armëve dhe pasoja e konfiskimit të tyre për civilët mund të zbritet nga fakti se Kosova ka qenë në mes të konfliktit dhe është e qartë se civilët i kanë mbajtur armët e tyre për ta mbrojtur vetën dhe familjet e tyre: vlera e artikujve dhe pasojat e plaçkitjes dhe konfiskimit të tyre është vlerësuar si e rëndësishme.

Kjo është arsyeja pse Gjykata Supreme nuk konsideron se marrja e armëve nga civilët P. L., T. K., G. Q. dhe M. P. është cilësuar në mënyrë të gabuar si konfiskim i kundërligjshëm i pronës dhe plaçkitje e cila përbën vepër penale sipas KP të RSFJ-së dhe Konventave të Gjenevës, të gjitha ligjeve të aplikueshme në kohën e kryerjes së veprave penale.

Gjykata Supreme është e kënaqur që gjykata e shkallës së parë nuk e ka shkelur ligjin penal në lidhje me këtë.

III.4. Papranueshmëria e dëshmive të dëshmitarëve B L dhe E L

Avokati mbrojtës pretendon se është shkelur procedura penale për faktin se dy dëshmitarët janë intervistuar gjatë fazës hetimore nga një Polic në të njëjtën dhomë njëri pas tjetrit.



Gjykata Supreme ka vërejtur se Polici në fjalë derisa ka qenë në gjykatë ka pranuar se ka intervistuar B. dhe E. L. në të njëjtën dhomë. Kolegji ka shqyrtuar nëse kjo i bën dëshmitë e dëshmitarëve të papranueshme. Në të vërtetë, neni 164 i KPPK-së thotë: “Dëshmitari pyetet ndaras dhe pa praninë e dëshmitarëve të tjerë”. Kolegji vëren se gjatë shqyrtimit gjyqësor dëshmitarët janë intervistuar në mungesë të njëri tjetrit.

Më tej, kolegji ka pasur në konsideratë nenin 153, par.1 të KPPK i cili thotë: “Provat e marra me shkelje të dispozitave të procedurës penale janë të papranueshme kur ky Kod ose dispozita të tjera të ligjit shprehimisht parashikojnë kështu.” Neni i lartë përmendur 164 shprehimisht nuk përmend se marrja në pyetje e dy dëshmitarëve në një fazë të procedurës e bën provën të papranueshme.

Kolegji përfundimisht vëren se Gjykata e Qarkut ka justifikuar arsyet¹ përse ka konsideruar se deklaratat e B. dhe E. L. ishin konsideruar si të pranueshme edhe pse ato nuk ishin marrë në mënyrë të rregullt.

Prandaj, Gjykata Supreme, gjithashtu duke pasur parasysh autoritetin e gjykatës së shkallës së parë për të vlerësuar lirshëm të gjitha provat e paraqitura me qëllim të vërtetimit të rëndësisë apo pranimi të tyre, në bazë të nenit 152 të KPPK nuk konstaton se marrja në pyetje e dy dëshmitarëve në të njëjtën dhomë gjatë fazës së hetimit përbën një shkelje esenciale të procedurës penale sikurse parashihet nga neni 403, paragrafi 1, nën paragrafi 8.

III.5. Alibia e dy dëshmitarëve të mbrojtjes

Mbrojtësi pretendoi se Gjykata e Qarkut nuk e ka vlerësuar si duhet alibinë e paraqitur nga dy dëshmitarët e mbrojtjes Kolë dhe Pashk Krasniqi dhe si rrjedhojë e ka vërtetuar gabimisht situatën faktike.

Pas rishqyrtimit me kujdes të provave të dhëna në gjykatë nga Kolë dhe Pashk Krasniqi, Gjykata Supreme vlerëson se, edhe pse që të dy kanë sjellë të njëjtin tregim, e që është, se në natën kritike, Gjelosh Krasniqi ishte duke përgatitur darkën për ushtarët e tjerë të UÇK-së në fshatin Nepolë dhe prandaj nuk ka mundur të jetë saktësisht në të njëjtën kohë në Doblubarë me ushtarët e tjerë të UÇK-së sikurse pretendohet nga Prokurori, ekzistojnë kundërthënie kyçe në mes të dy tregimeve të cilat nuk mund të shpjegohen me kalimin e kohës.

Për shembull, dy dëshmitarët kanë sjellë versione të ndryshme në lidhje me moshën e ushtarëve të UÇK-së të pranishëm atë natë, për atmosferën në fshat, për praninë apo mos praninë e të pandehurit ditën tjetër, për rregullat që duhet respektuar nga ushtarët.

Gjykata Supreme konstaton se në këtë pikë të veçantë, Gjykata e Qarkut ka vlerësuar mjaftueshëm besueshmërinë e provës kontradiktore sipas nenit 396 par. 7 të KPPK duke

¹ Shih faqen 90 dhe 91 të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Pejës më datë 29 prill 2009.



vlerësuar secilën pikë të provës ndaras dhe në ndërlidhje me pikat e tjera (neni 387) në faqet 88 dhe 89 të aktgjykimit.

Sikurse është theksuar më parë në këtë aktgjykim mbi vlerësimin e besueshmërisë së deklaratave të dëshmitarëve gjatë fazës hetimore dhe gjatë fazës së shqyrtimit gjyqësor për identifikimin e të pandehurit, roli kryesor i shkallës së parë është për të vlerësuar besueshmërinë e provave kontradiktore.

Gjykata Supreme konstaton se vlerësimi i provave është bërë nga gjykata e shkallës së parë në pajtim me kushtet ligjore dhe në mënyrë të kujdesshme, transparente dhe bindëse. Në përfundim, Gjykata Supreme nuk gjen vërtetimi të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike në aktgjykimin e ankimuar.


III.6 Dënimi

Mbrojtja pretendon se gjykata e shkallës së parë mori në konsideratë vetëm rrethanat rënduese në shqiptimin e dënimit sikurse dënimi i mëparshëm i të akuzuarit për vrasje si i mitur dhe të tilla si një hetim kriminal në SH.B.

Gjykata Supreme me kujdes ka vlerësuar rrethanat e shqyrtuara nga gjykata e shkallës së parë sa i përket dënimit, në veçanti duke rishqyrtuar faqen 95 të aktgjykimit. Gjykata e shkallës së parë e konsideroj si rrethanë rënduese faktin se i pandehuri kishte kryer tashmë një vrasje kur ishte i mitur dhe si rrethana lehtësuese faktin se i pandehuri ishte relativisht i ri, kur ka kryer veprat penale. Para së gjithash, gjykata e shkallës së parë nuk i referohet aktakuzës të ngritur në SH.B. kundër të pandehurit për grabitje dhe posedim të armëve të zjarrit në lidhje me krimin e dhunës. Kjo nuk ishte konsideruar si rrethanë rënduese nga gjykata e shkallës së parë, dhe me të drejtë, duke pasur parasysh ekzistimin e supozimit të pafajësisë. Së dyti, gjykata e shkallës së parë ka marrë parasysh një rrethanë lehtësuese që është mosha e re e të pandehurit në kohën e kryerjes së veprës penale, kështu që pohimi i avokatit mbrojtës që kolegji nuk ka konsideruar asnjë rrethanë lehtësuese nuk qëndron. E treta nga të gjitha, gjatë leximit të procesverbalit dhe në veçanti fjalimin përmbyllës të avokatit mbrojtës, gjykata nuk ka gjetur një referencë nga mbrojtësi për faktin se i pandehuri kishte anëtarë të sëmure të familjes. Prandaj, Gjykata Supreme konstaton se gjykata e shkallës së parë ka konsideruar si duhet edhe rrethanat e lartpërmendura lehtësuese dhe edhe rënduese.

Së fundi, sipas nenit 142 të KP të RSFJ-së, vepra penale *Krime lufte kundër popullatës civile* dënohet me burgim nga pesë deri në 20 vjet. Prandaj, Gjykata Supreme vë në pah se kohëzgjatja e burgimit e shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë me shtatë vjet burgim është i përshtatshëm duke pasur parasysh rrethanat përkatëse në lidhje me veprën penale dhe të pandehurin.

III. 7. Vlerësimi ex officio i çfarëdo shkelje në pajtim me nenin 415 të KPPK



Gjykata Supreme është po ashtu nën detyrim sipas nenit 415 të KPPK për të shqyrtuar *ex officio* nëse ekziston shkelje e dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403 paragrafi 1 nën paragrafët 1, 2, 6 dhe 8 deri 12 i KPK-së, nëse shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në mungesë të të akuzuarit, nëse shqyrtimi gjyqësor u zhvillua në mungesë të avokatit mbrojtës dhe nëse ligji penal është shkelur në dëm të të akuzuarit.

Gjykata Supreme ka shqyrtuar me kujdes në veçanti dispozitivin e aktgjykimit të Pejës të lëshuar më 29 prill 2009 për të vlerësuar nëse kjo mund të konsiderohet si një shkelje esenciale e procedurës penale sipas nenit 403, paragrafi 1, nën paragrafi 12. Përmbajtja e dispozitivit është diskutuar tashmë në disa raste nga ana e Gjykatës Supreme² me qëllim për të vlerësuar nëse një dispozitiv që përmban detaje të kufizuara vetëm për faktet dhe rrethanat e veprave penale në fjalë duhet të konsiderohet si i pakuptueshëm në pajtim me nenin 403, paragrafi 1, nën-paragrafi 12.

Dispozitivi i aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Pejës në lëndën P.nr. 67/09, i datës 29 prill 2009 thotë me sa vijon:

"I akuzuari është SHPALLUR FAJTOR për Krime Luftë kundër Popullatës Civile, në kundërshtim me nenin 142 të Kodit Penal të RSFJ-së, nenet 3 dhe 147 të Konventës 4 të Gjenevës, nenit 4 i Protokollit Shtesë II të Konventave të Gjenevës, për marrje peng të P. L. dhe për konfiskim të paligjshëm të pronës dhe plaçkitjen e një pushkë AK-47 dhe një pistoletë 7,65 nga P. L., një pushkë M-48 nga T. K. një pushkë M-48 dhe një pistoletë CZ 99, 9 mm nga G. Q., një revole Bronvik 7.65 mm nga M. P. në fshatin Doblibarë, komuna e Gjakovës, më 24 mars 1999."


Gjykata Supreme konsideron se këtij dispozitivi, edhe pse në parim i plotëson të gjitha kushtet nga Neni 396, paragrafët 3 dhe 4 të KPPK-së – në rastin më ideal do të mund të përmbante më shumë detaje mbi faktet vendimtare, i mungojnë arsyet më të hollësishme mbi faktet vendimtare që neni 391 paragrafi 1 i KPPK-së kërkon të jenë të shënuar në mënyrë të plotë në pjesën e 'arsyetimit' të çdo aktgjykimi.

Në të vërtetë, dispozitivi përmend emrin e viktimave, si dhe vendin dhe kohën e kryerjes së veprave penale, përveç veprave penale dhe dispozitave përkatëse ligjore. Siç u tha më parë nga Gjykata Supreme, një aktgjykim duhet të konsiderohet si një dokument i veçantë i përbërë nga tri pjesë: hyrja, dispozitivi dhe arsyetimi sipas nenit 396 paragrafi 1 i KPPK. Pasi që dispozitivi është një pjesë integrale (dhe më vendimtare) e aktgjykimit, ai duhet të lexohet dhe interpretohet në lidhje me të gjitha pjesët e tjera të aktgjykimit.

Në miratimin e kësaj pozite, Gjykata Supreme ka pasuar pozitën e marrë më parë në lëndën *Latif Gashi et al.* të datës 26 janar 2011 që deklaroi:

"Në veçanti nuk mund të jetë ratio legis i dispozitave përkatëse të ligjit të procedurës penale në fuqi, që në lëndën në fjalë është LPP, të ketë fakte të cituar disa herë në"

² Aktgjykimi Ap-Kz 108/2010, Idriz Gashi, 25 nëntor 2010, Aktgjykimi Ap-Kz 128/2010, F.B. 3 gusht 2010, Aktgjykimi Ap.-Kz. Nr. 89/2010. Latif Gashi et al., 26 janar 2011



aktgjykim, në veçanti në hyrje, në dispozitiv dhe ndoshta përsëri në pjesën e arsytimit të aktgjykimit, vetëm për arsye formale ose për të përfshirë pjesët e mëdha dhe të domosdoshme të një pjesë të aktgjykimit po ashtu në një pjesë tjetër të të njëjtit aktgjykim, në lëndën në fjalë në dispozitiv. Ndërsa dispozitivi në fjalë është i qartë dhe i kuptueshëm, aktgjykimi duhet të konsiderohet si një dokument i veçantë i përbërë nga tri pjesë që janë hyrja, dispozitivi si edhe arsytimi (neni 357 paragrafi 1 i LPP). Pasi që dispozitivi është një pjesë integral (dhe më vendimtare) e aktgjykimit ai duhet të lexohet dhe interpretohet në lidhje me të gjitha pjesët e tjera të aktgjykimit.”

Gjykata Supreme është e mendimit se faktet dhe rrethanat të cilat kanë mundur të përmenden në dispozitivin e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Pejës megjithatë janë dhënë në hollësi në arsytim dhe në veçanti nga faqja 85 deri 95. Prandaj, kolegji konsideron se në këtë lëndë dispozitivi është mjaft abstrakt madje edhe sa i përket pjesës përshkuese të tij, por se megjithatë ky fakt nuk përbën shkelje esenciale të procedurës penale sipas nenit 403, paragrafit 1, nënparagrafit 12 të KPPK-së. Në veçanti dispozitivi në aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Pejës nuk është i pakuptueshëm ose kundërthënës në brendinë e tij apo në kundërshtim me arsytimin e aktgjykimit. Është plotësisht e qartë për cilat veprime i pandehuri është shpallur fajtor, kush janë viktimat, vendi dhe koha e veprave penale. Për më tepër, kolegji gjithashtu mori parasysh faktin se avokati mbrojtës në ankesën e tij nuk pohoi se dispozitiv nuk ishte në pajtim me nenin 391, paragrafin 1 të KPPK-së.


Kolegji ka arritur në përfundim se dispozitivi nuk përbën shkelje të procedurës penale apo shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit dhe prandaj anulimi i aktgjykimit dhe kthimi i çështjes në gjykatën e shkallës së parë nuk mund të arsyetohet .

Gjykata Supreme nuk ka identifikuar *ex officio* ndonjë shkelje tjetër nga neni 415 paragrafi 1 i KPPK.

IV KONKLUZION

Prandaj u vendos si në dispozitiv.

Më datë 14 qershor 2011.
Ap.-Kž. Nr. 353/2009



Përgatitur në Anglisht, gjuhë e autorizuar.

Kryetari i kolegjit

Charles L. Smith III

Anëtar i kolegjit

Gerrit-Marc Sprenger

Anëtare e kolegjit

Marije Ademi

Procesmbajtësja

Olivia Debaveye

Anëtar i kolegjit

Martti Harsia

